



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 88/12
Prishtinë, më 12.12.2012, ora 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama dhe Duda Balje.

Mungoi: Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli, dhe Albulena Gashi (praktikant).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013

Kryetarja njoftoi se Komisionet për Legjislacion dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve e kanë shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 dhe e kanë përkrahur atë. Gjithashtu edhe Komisioni për Integritet Evropian e ka përkrahur projektligjin dhe amendamentet e komisionit, mirëpo kanë bërë një kërkesë që kanë kërkuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa të rishqyrtojë ekonominë buxhetore të Kuvendit të Kosovës, që sipas arsyetimit thuhet se kjo çështje është ngritur në raportin e fizibilitetit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2012. Mendojë që është një rekomandim i pakuptimtë ajo çfarë është kërkuar nga ana komisionit. Ne si komision, kemi vepruar në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Rregulloren e Kuvendit, me rastin e shqyrtimit të propozim buxhetit të përgatitur nga administrata e Kuvendit. Ne kemi shqyrtuar propozim-buxhetin e përgatitur nga administrata e Kuvendit sipas qarkoreve buxhetore dhe i kemi rekomanduar Kryesisë së Kuvendit. Është hera e parë që Qeveria nuk ka ndërhyrë aspak në buxhetin e Kuvendit dhe është përfshirë në tërësi në projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2013, siç ka rekomanduar Komisioni dhe siç e ka aprovuar Kryesia e Kuvendit.

Sali Asllanaj është e vërtetë që këtë vit nuk ka pasur ndërhyrje nga qeveria në buxhetin e Kuvendit, por mendoj që mënyra se si përcaktohet buxheti i Kuvendit, lenë gjithmonë mundësinë e ndërhyrjes nga ana qeverisë. Vërtetë është absurde që Kuvendi të shkojë në qeveri të kërkojë miratimin e buxhetit, kur dihet se ne jemi punëdhënësi, dhe së paku Kuvendi ta ketë atë privilegj të caktoj buxhetin dhe qeveria të mos caktoj kurrfarë limiti buxhetor për Kuvendin. Ne kemi vepruar në pajtim me Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike me rastin e shqyrtimit të buxhetit të Kuvendit dhe nuk ka pasur ndonjë shkelje, por duhet merret iniciativa për ndryshimin e ligjit që përcakton se qeveria nuk mund të caktojë limitet buxhetore për Kuvendin.

Latif Gashi mendojë që edhe Kuvendi është organizatë buxhetore sikurse edhe organizatat tjera dhe duhet të vlejë parimet e përgjithshme në përgatitjen dhe përcaktimin e buxhetit. Ne kemi vepruar në pajtim me ligjin në fuqi në shqyrtimin e buxhetit të Kuvendit dhe aktualisht nuk po shoh se mund të bëjmë diçka deri sa ligji për menaxhimin e financave publike është në fuqi.

Naser Osmani habitem pse kjo çështje iu është adresuar Komisionit për buxhet dhe financa. Ajo çfarë është e rëndësishme, do të duhej të vihej një rregull financiar buxhetore, që do të duhej të vlejë për të gjitha organizatat buxhetore, që do të duhej të përgatisin dhe dorëzojnë buxhetin në Ministrinë e Financave dhe kjo nuk nënkupton përzierjen e qeverisë në pavarësinë e institucioneve të pavarura. Institucionet e pavarura nuk mundin të përcaktojnë buxhetin e tyre dhe duhet ekzistoj një rregull dhe disiplinë fiskale dhe buxheti duhet përgatitur në Ministrinë e Financave dhe më pastaj Kuvendi është autoriteti i fundit që mund të bëjë korrigjimet bazuar në kërkesat e arsyeshme. Kjo duhet të bëhet me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të planifikimeve buxhetore dhe arsytimit të kërkesave të tyre. Nuk ka pavarësi të institucioneve aspektin e financave, pavarësia e institucioneve është në kryerjen e veprimtarisë të tyre.

Kryetarja pajtohem me mendimet e nënkryetarit, pasi që po përballemi me mjaft probleme të natyrës së tillë dhe unë jam idhnare e asaj që të kemi një planifikim të mirë të buxhetit nga ana Kuvendit dhe mos të ketë ndërhyrje të buxhetit nga ana qeverisë. Por se mendojë që të gjitha organizatat buxhetore do të duhej ti nënshtrohen rregullave buxhetore në përgatitjen e buxhetit dhe është shumë e rëndësishme krijimi i disiplinës financiare.

Xhevdet Neziraj janë në mendimin e njëjtë të kryetarës dhe nënkryetarit dhe nuk duhet që institucionet e pavarura të caktojnë buxhetin apo pagat e tyre si të duan, por se duhet ekzistoj një rregull e njëjtë për të gjithë. Në shumë vende, ekzistoj një autonomi buxhetore por se kjo çështje është e rregulluar me ligj dhe ne për momentin nuk mund të bazohemi në ligje për të trajtuar autonominë buxhetore të Kuvendit. Duhet të ketë dhe të respektohet disiplina financiare për të gjitha organizatat buxhetore.

Sali Asllanaj mendojë që nuk duhet të trajtohet Kuvendi dhe të krahasohet me institucionet tjera. Kuvendi është punëdhënësi i qeverisë dhe që miraton ligjet, përfshirë edhe Kushtetutën. Kuvendi duhet të përgatit buxhetin, të vlerësoj nevojat dhe kërkesat dhe qeveria nuk duhet të ketë qasje për ndërhyrje dhe të përfshijë buxhetin siç është përgatitur nga Kuvendi në projektligjin për buxhetin e Kosovës.

Kryetarja ju lutem mos të keqkuptohemi, ne kemi një buxhet të konsoliduar. Po ashtu nga vizitat studimore që kemi realizuar në vendet tjera, kemi kuptuar se procedurat e përgatitjes së buxhetit janë të ngjashme ashtu sikurse edhe tek ne. Këtë e kemi parë edhe në shtetet e zhvilluara siç është Gjermania.

Hykmete Bajrami pajtohem me Salihun, se Kuvendi nuk mundet me u krahasuar me agjensionet e pavarura sepse ne jemi të përzgjedhurit e popullit e institucionet e pavarura janë ato që ne i kemi zgjedhur. Mendojë që këto çështje duhet trajtuar me rastin e iniciativës së ndryshimit të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe të rregullohet kjo punë. Ne kemi shumë probleme sidomos me agjensionet e pavarura

dhe gjithmonë po themi se i kemi krijuar shumë agjencione të tilla nën presionin e bashkësisë ndërkombëtare apo komisionit evropian, e të cilat po bëjnë kërkesa të paarsyetuara, por nuk është keq edhe kjo vërejtje të adresohet .

Naser Osmani me ligje të veçanta është përcaktuar çështja e përcaktimit të buxhetit të institucioneve të pavarura apo për Kuvendin me rregulloren e punës. Çështja është se po kërkohet autonomi e plotë buxhetore për Kuvendin. Këtë vit ashtu siç u tha nuk ka pasur ndërhyrje në kërkesa buxhetore të Kuvendit në asnjë kategori as nga qeveria as nga komisioni. Kërkesa shtesë që janë bërë ndërkohë nga administrata e Kuvendit për investime kapitale, pas diskutimeve në grup punues, janë të tërhequr dhe është lënë për rishikimin e buxhetit. Ajo çfarë thotë Salihu, jam për pavarësinë totale buxhetore për institucionet lokale por jo edhe atyre qendrore.

Hykmete Bajrami çështja e buxheti është vetëm një pjesë e problemit që ka ngritur komisioni evropian, pasi që zakonisht jep vërejtje se qeveria po e kontrollon Kuvendin. Unë kam vërejtje për mënyrën se si përpilohet buxheti i Kuvendi, dhe asnjë komision i kuvendit, deputetët nuk bëjnë kërkesa dhe nuk kanë qasje në buxhet dhe buxheti i Kuvendit caktohet nga sekretari i Kuvendit. Ne si deputet nuk kemi kushte elementare për punë, nuk kemi zyre. Edhe sikur të ekziston autonomia plotë e Kuvendit po ju premtoj se prapë ka me qenë në harmoni me kërkesat e qeverisë, dhe edhe po ta caktonte Kuvendi buxhetin, nuk do të kalonte ai propozim, por diçka që ka caktuar dikush tjetër dhe e gëzon shumica.

Latif Gashi është një temë e gjërë për të cilën nuk kemi hapësirë për ndërhyrje sepse ne kemi vepruar konform ligjeve në fuqi. Pajtohem plotësisht me atë çfarë theksoi nënkryetari se janë përkrahur të gjitha kërkesat buxhetore të Kuvendit, ndërkaq nuk jam dakord me mendimin e Salihut dhe Hykmetes për autonomin e plotë buxhetore.

Kryetarja mendojë që në emër të komisionit në Kuvend në fjalën hyrëse, do të duhej të jepet një sqarim për shqyrtimin e buxhetit të Kuvendit për vitin 2013 dhe do të sqarojë se çdo gjë ka kaluar në komisionin për buxhet dhe financa dhe nuk ka pasur ndërhyrje nga ana e qeverisë në buxhetin e Kuvendit. Si komision, kemi vepruar në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullores së Kuvendit me rastin e shqyrtimit dhe rekomandimit për buxhetin e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi: 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj